

Kolegji ESLG

MEMORANDUM PËR BASHKPUNIM DHE NJOHJE TË NDËRSJELLTË

NDËRMJET

Kolegjit "ESLG"- Prishtinë
dhe
Anem Real Estate Agency

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Me këtë memorandum palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar arritjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të menaxhimit të patundshmërive, infrastrukturës së energjisë, eficiencës së energjisë, qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit efikas të sektorit ndërtimor dhe atij të energjisë;

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. **Anem Real Estate Agency** zotohet se do të ofrojë këshillat e saj për përpilimin e planprogrameve moderne të lëndëve përkatëse në programin Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) dhe (MA) dhe Menaxhimi i Energjisë niveli bachelor;
2. **Anem Real Estate Agency** zotohet se do të ofrojë praktikën për studentët e programit Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) dhe Menaxhimi i Energjisë (BA), Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA) dhe Menaxhimi i Energjisë (BA);
3. **Anem Real Estate Agency** zotohet se do të zhvillojnë projekte të përbashkëta hulumtimi me profesorët dhe studentët e Kolegjit ESLG.;
4. Stafi akademik i Kolegjit ESLG ofron ndihmën këshilldhënëse për **Anem Real Estate Agency** dhe gjithashtu do të bashkëpunojnë në hulumtime dhe analiza të përbashkëta të cilat janë në favor të sektorit privat;
5. **Anem Real Estate Agency** do të udhëzojë bashkëpunëtorët e vet që të avansohen në nivelin akademik në kuadër të programeve unike të Kolegjit ESLG;

6. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve rreth standardeve dhe praktikave më të mira në fushën e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të menaxhimit të paluajtshmërive dhe menaxhimit të energjisë;
7. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "ESLG" dhe Anem Real Estate Agency.;
8. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse ndërmjet palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Ky Memorandum hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit;
3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 10.01.2018

PALËT NËNSHKRUESE

Anem Real Estate Agency

Drejtor

Edmond Belegu



Kolegji "ESLG"

Rektor

Prof. Asoc. Dr. Visar Hoxha

